



**BASHKIA MIRDITË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 5011/1 Prot.

Rrëshen me, 30 . 12 . 2020

**V E N D I M**

**Nr. 118 datë 23. 12. 2020**

**PËR**  
**“MIRATIME KALENDARIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2022-2024**  
**DHE BUXHETI VJETOR”, BASHKIA MIRDITË.**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015" Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr.68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Udhëzimi nr. 23, datë 30.07.2018, të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore", dhe projekt-vendimin e paraqitur nga kryetari i bashkisë dhe *shqyrtimit në komisionin e ekonomisë, financës dhe buxhetit me datë 16.12.2020*, këshilli bashkiak pas diskutimeve në seancë;

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm 2022 – 2024 dhe të buxhetit vjetor, bashkia Mirditë, sipas tabelës bashkëlidhur dhe pjesë përbërse e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet bashkia Mirditë, (drejtoria e menaxhimit financiar dhe e buxhetit).

*Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.*

**SEKRETAR**

**Gaspar TOPOLLAJ**



**KRYETAR**

**Pjeter PJETRI**

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

KALENDAR I PROGRAMIT BUXHETORE AFATMESEM 2022-2024 DHE I BUXHETIT VJETOR.

PERIUDHA	DATA	INSTITUCIONI/PERSONI PËRGJEGJËS	VEPRIMI PERKATES						
Dhjetor	Brënda muajt dhjetor	Kryetari i NJQV-së	Përgatit dhe paraqet në Këshillin Bashkiak Kalendarin e programit buxhetor afatmesëm						
Dhjetor	Deri - 31 Dhjetor	Këshilli i Njesisë Vendore	Shqyrton dhe miraton Kalendarin e programit buxhetor afatmesëm						
Janar	15	Kryetari i NJQV-së	Kryetari shpërndan kalendarin e programit buxhetor afatmesëm tek të gjitha njësitë shpenzuese						
Janar	31	Kryetari i NJQV-së	Kryetari i njesisë paraqet për shqyrtim dhe miratim raportin e vlersimit të të ardhurave						
Mars	1	Këshilli i Njesisë Vendore	Miraton raportin e vlerësimit të të ardhurave						
Mars	Brenda dates 15	Kryetari i NJQV-së	Paraqet për miratim në Këshillin e NJQV-së tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA						
Mars	15	Këshilli i Njesisë Vendore	Miraton tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm						
Mars	20	Kryetari i NJQV-së	Miraton udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të njesisë vendore dhe e shpërndan tek njësitet shpenzuese						
Mars - Prill	21 Mars - 25 Prill	Njesite shpenzuese të bashkisë	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore						
Mars - Prill	26 Prill - 27 Prill	Njësia e vetëqeverisjes vendore	Zhillojnë takime konsultative me shoqërinë civile dhe grupet e interesit për PBA 2022-2024						
Mars - Prill	28 Prill - 30 Prill	Njësitë shpenzuese të Bashkisë	Njësitë shpenzuese paraqesin në bashki kërkesat e përgatitura						
Maj	1 Maj - 15 Maj	Njësia përgjegjëse për buxhetin në	Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore						
Maj	16 Maj - 26 Maj	Kryetari i NJQV-së	Organizon seancat dëgjimore me Banorët						
Maj	27 Maj - 29 Maj	Kryetari i NJQV-së	Prezanton dokumentin e PBA 2022-2024 me shoqërinë civile						
Maj	30 Maj - 31 Maj	Njësia përgjegjëse për buxhetin në	Perpilon draftin e fazes së parë të PBA-së 2022-2024						
Qershor	1	Kryetari i NJQV-së	Dërgon pranë Ministrisë së Financave projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm						
Qershor	Deri - 20	Ministria e Financave	Dërgon komente një raport me mendime mbl projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm						
Qershor	Deri - 25	Njësia përgjegjëse për buxhetin në	Reflekon komentet e MInistrisë së Financave						
Qershor	Deri - 30	Këshilli i Njesisë Vendore	Shqyrton dhe miraton projektin e parë të programit buxhetor afatmesëm						
Korrik	Deri - 5 Korrik	Kryetari i NJQV-së	Merr masat për publikimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm						
Korrik	Deri - 20 Korrik	Këshilli i Njesisë Vendore	Miraton tavanet përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm						
Korrik	25	Kryetari i NJQV-së	Miraton udhëzimin plotësues të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe shpërndan tek njësitë shpenzuese						
Korrik - Gusht	26 Korrik-31 Gusht	Njësitë shpenzuese të bashkisë	Përgatisin kërkesat buxhetore të rishikuara, në përputhje me tavanet përfundimtare.						
Shtator	1	Njësitë shpenzuese të bashkisë	Njësitë shpenzuese paraqesin në bashki kërkesat buxhetoretë rishikuara						
Shtator	2 Shtator - 14 Shtator	Njësia përgjegjëse për buxhetin në	Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore						
Shtator	Deri - 15	Kryetari i NJQV-së	Dërgon në Ministrinë e Financave dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar						
Shtator-Tetor	Deri 5 Tetor	Ministria e Financave	Organizohen seanca konsultimi me njwsiw e vetwqeverijses vendore						
Tetor	Deri - 20 Tetor	Ministria e Financave	Sipas rastit, Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për t'u reflektuar në dokumentin final të PBA						
Tetor-Nentor	6 Tetor -30 Nentor	Njësia përgjegjëse për buxhetin në	Përgatit Projektbuxhetin e vitit 2022 si dhe, dokumentin e rishikuar të PBA 2022-2024 dhe i paraqet për shqyrtim në Këshilli.						
Dhjetor	25	Këshilli i njesisë vendore	Miraton programin buxhetor afatmesëm përfundimtar dhe buxhetin vjetor						
Dhjetor	31	Kryetari i NJQV-së	Merr masat për publikimin dokumentin e plotë të programit buxhetor afatmesëm						